

SHENIME SPJEGUESE
P E R
PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE "EKSPRES-BETON LEZHE" SHPK
LEZHE
Ushtrimi i mbyllur me 31.12. 2019

I. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHE" Sh.p.k është rregjistruar ne QKB, ne datë 03/02/2006 me seli në adresën: Godine (Zyra) dhe shesh prodhimi nr. pasurie 82/61, ZK. 2604, Zejmen MARKATOMAJ Lezhe. Administrator I Shoqërisë është Z. Petrit Deda
NIPT: K58515501V

Objekti i veprimtarise është: "Prodhim betoni të markave të ndryshme dhe tregtimit të tij me shumicë e pakicë. Prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, të inerteve, blloqe e soleta betoni, nyje për prodhim betoni, tregtim të prodhimit të betonit dhe elementeve beton - arme, tregtimin e pjesëve të këmbimit për makina dhe automjete, pikë servisi, lavazh makinash, gomisteri, pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante si dhe gazit të lëngët me pakicë, import - eksport të artikujve ushqimorë dhe atyre industrial, importimin e makinerive bujqësore, elektroshtëpiake dhe transportin e mallrave dhe pasagjerëve brenda dhe jashtë vendit."

Numrin mesatare të punëmarrësve gjatë periudhes është 2 punonjës.

Përsón përgjegjës për përpunimin e informacionit për hartimin e pasqyrave financiare: Sadete Rrenga Kontabel i Miratuar me liçence nr. 71, date. 25.10.2011.

Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" "EKSPRES-BETON LEZHE" Sh.p.k kategorizohet në: Mikronjësi ekonomike.

Kuadri ligjor: Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kontabël Kombëtare SKKP Nr2.

Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare: (SKK 1; 40 - 90)

Parimi i njësisë ekonomike: mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta; Parimi i vijimësisë: veprimtaria ekonomike e njësisë sonë raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj; Kompensimi: Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1, Parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave

financiare, aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejtë ligjore t'i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe ekziston mundësia që ajo ta përdorë këtë të drejtë; Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo,që të marra veças nuk janë materiale; Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit; Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKKP Nr.1 janë:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri.
- Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
- Parimin e paanëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
- Parimin e maturisë pa optimizem të tepruar,pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
- Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare.
- Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël.
- Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2019-31.12.2019.

II. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të përmirësuar (SKKP).

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SKKP për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të performancës dhe ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Leke.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2019.

Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Biznesi në vijimesi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

Kurse e këmbimit	31.12.2019	31.12.2018
Euro/Leke	121,77	123,42
USD/ Leke	108,64	107,82

III. Politikat kontabile

1. Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër.

Instrumentat financiarë të shoqërise përbëhen nga: mjetet monetare; një instrument borxhi (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) që plotësojnë kushtet në paragrafin 7 të SKKP nr.3.; një zotim për të marrë një hua e cila: (i) nuk mund të paguhet në para, dhe (ii) kur zotimi realizohet, pritet që ai të plotësojë kushtet e dhëna në paragrafin 7 SKKP nr.3.

Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të Instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë Instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëposhëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera tejet likuide me maturim fillestar prej tre ose më pak muajsh.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e drejtimit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar

Huadhënie dhe huamarrje

Huate e Dhëna: Huate e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara sipas kushteve kontraktuale me pagesa fikse dhe variabel në varësi të normave të interesit të cilat nuk janë të kuotuar.

Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuar.

Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Huate e marra: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut plus kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar.

Shpenzimet interesit të llogaritur me normën interesit efektive (NEI) i cili pasqyrohet në rezultat llogariten me vlerën e drejtë dhe pasqyrohen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmerish një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund ti shtohen kostos së këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për t'u përdorur ose shitur.

Netimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efektë negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Ç`regjistrimi i instrumentave financiare

Aktivitet financiare se bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

Instrumentat financiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

2. Inventaret

Inventaret regjistrohen në konatbilitet me kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Për përcaktimin e kostos së inventareve është zgjedhur metoda e kostos mesatare.

3. Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-t)

Njohja dhe Matja : Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja Mepashme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjesë minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësiat e ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të AAM-ve metodën e amortizimit mbi bazën e vlefës së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur normat menaxheriale si më poshtë:

<u>Llojet e Aktiveve Afatgjata</u>	<u>Normat e aplikuar</u>	<u>Metoda e aplikuar</u>
Materiale		
Makinë dhe pajisje	20%	Me vlerë të mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlerë të mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlerë të mbetur
Të tjera	20%	Me vlerë të mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me vlerë të mbetur
Ndërtesa	5%	Me vlerë të mbetur
Jo materiale		
Konçensione, patenta, licenca	15%	Lineare

Tokat dhe Investimet në proces nuk amortizohen.

Ç`regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjatë materiale ç`regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivët Afatgjatë Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë licencat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

4. Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthorte) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar për të cilën ka mundësi që të krijohen një rrjedhë burimesh të nevojshme për të përmbushur detyrimin dhe kur një përllogaritje e besueshme e shumës së detyrimit mund të llogaritet. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një rrjedhe burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht.

Pasivet dhe aktivet e kushtëzuara nuk njihen, por vetëm paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare të ndermjetme kur janë materiale.

5. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

7. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të mallit/sherbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

Shpenzimet

Shoqëria njih shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i shoqërisë.

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 dhe 2018 paraqiten më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Tatimi fitimi	15%	15%

9. Dividendë

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

10. Kapitali i Vet

Kapitali i nënshkruar përfaqëson kontributin e ortakeve në datën e krijimit të shoqërisë dhe ndryshimet gjatë veprimtarisë. Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

11. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë të shoqërisë, në datën e bilancit kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

IV. Informacion mbi zerat materiale te paraqitur ne pasqyrat financiare

A- AKTIVET

A1- Aktivet afatshkurtera

1. Aktivet monetare

Cash sipas monedhes	31.12.2019	31.12.2018
BANKA LEKE	0	0
BANKA EURO	86,093	87,259
ARKA LEKE	0	0
TOTALI	86,093	87,259

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e arkës dhe bankës, janë veprime të autorizuara, mbështeten në dokumenta që justifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike.

2. Të drejta të arkëtueshme

Të drejta të arkëtueshme	31.12.2019	31.12.2018
KLIENTE LEKE	6,680,600	2,570,000
TOTALI	6,680,600	2,570,000

A2- Aktivet afatgjata

i.- Aktivet materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale per vitin 2019, vleresuar me koston historike te tyre eshte si vijon :

AAM	Ndërtesa	Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informative	TOTALI
Gjendje me 01.01.2019	118,488,810	24,885,729	8,672,701	493,420	61,715	152,602,375
Shtesa investime	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2019	118,488,810	24,885,729	8,672,701	493,420	61,715	152,602,375
Amortizimi	-	-	-	-	-	-
Gjendje me 01.01.2019	31,855,264	22,034,504	7,044,677	221,161	50,731	61,206,337
Shtesa amortizimi	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2019	31,855,264	22,034,504	7,044,677	221,161	50,731	61,206,337
Vlera e mbetur neto						

Gjendje me 01.01.2019	86,633,546	2,851,226	1,628,024	272,259	10,984	91,396,038
Gjendje me 31.12.2019	86,633,546	2,851,226	1,628,024	272,259	10,984	91,396,038

Amortizimi i aktiveve afatgjata nuk eshte llogaritur ne perputhje me ligjin nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat " i ndryshuar pasi shoqeria ka ndaluar aktivitetin.
Keto aktive jane iventarizuar me 31.12.2019. Ato ekzistojne, jane vleresuar drejte, dhe deklarohen ne menyre korrekte me vleren e mbetur.

ii.- Aktivet afatgjata jomateriale

Shoqeria nuk ka gjendje te aktiveve afatgjata jomateriale

B-PASIVET

B1. Detyrimet afatshkurtra

i. Të pagueshme për aktivitetin e shfryzimit

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
FURNITORE LEKE	27,147,522	23,491,836
FURNITORE EURO	4,134,812	4,190,839
TOTALI	31,282,334	27,682,675

ii. Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve

	31.12.2019	31.12.2018
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	843,257	0
TOTALI	843,257	0

iii. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Paga dhe shpërblime	687,393	277,056
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	3,360,818	3,231,895
TOTALI	4,048,211	3,508,951

iv. Te pagueshme per detyrimet tatimore.

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Tatim mbi fitimin	1,131,725	1,131,725
TVSH	3,734,887	3,659,068
TOTALI	4,866,612	4,790,793

B2- Detyrimet afatgjata -Huamarrjet afatgjata

	31.12.2019	31.12.2018
Union Bank	49,440,637	49,440,637
BKT	9,927,606	10,770,864
TOTALI	59,368,244	60,211,501

C- Kapitali dhe rezervat

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Kapitali i paguar	43,384,000	43,384,000
Rezerva ligjore	491,251	491,251
Fitimi/Humbja e pashpërndarë	(46,015,874)	(42,666,126)
Rezultati i ushtrimit	(105,304)	(3,349,749)
TOTALI	(2,245,927)	(2,140,624)

- REZULTATI I USHTRIMIT**- Të ardhurat nga aktiviteti**

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Shitje e produkteve të gatshëm	4,525,829	300,000
Te ardhura nga shitje AAM	0	2,849,837
TOTALI	4,525,829	3,149,837

- Shpenzime te aktivitetit

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Lëndë djegëse	(4,137,013)	0
Paga dhe shperblime	(462,091)	(288,000)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsose	(77,169)	(48,096)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	0	(528,820)
Shpenzime te tjera shfrytezimi		
Mirëmbajtje për prodhimin, magazinimin	(9,725)	0
Gjoha dhe dëmshpërblime	0	(62,638)
Vlera kontabel e AAM ne shitje	0	(7,734,450)
TOTALI	(4,685,998)	(8,662,004)

- Te ardhura dhe shpenzime financiare

Pershkrimi	31.12.2019	31.12.2018
Fitim nga kembimet valutore	56,027	5,089,508
Shpenzime për interesa	0	(2,927,090)
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	(1,162)	0
TOTALI	54,866	2,162,418

- Rezultati Tatimor

Fitimi (Humbja) para tatimit	(105,304)	(3,349,749)
Humbje e mbartur	0	0
Shpenzime te panjohura	0	62,638
Rezultati tatimor	(105,304)	(3,287,111)
Tatim fitimi 15 %	0	0
FITIMI NETO I SHOQERISE	(105,304)	(3,349,749)

C.-Shënime të tjera shpjeguese

- Palet e lidhura

Kompensimi i manaxherëve kryesor të shoqërisë

Palët quhen të lidhura kur njëra prej tyre ka mundësinë të kontrollojë palët e tjera ose të ushtroje ndikim domethënës në vendim-marrjen financiare dhe operacionale të tyre. Nuk ekzistojnë maredhenie me pale të lidhura.

- Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

- Kontrolle tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 31.12.2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

- Ngjarje pas datës së bilancit

Me 31 Dhjetor 2019 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Tirane me 10.06.2020

Hartuesi i Pasqyrave Financiare



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
Petrit Deda

ADMINISTRATOR

